



SHKOLLË VERORE PËR ETNICITET DHE STUDIME TË MIGRIMIT - SLOVAKI

Shkolla Verore për Etnicitet dhe Studime të Migrimit është program edukimi dyjavor, që do të realizohet në Republikën e Sllovakisë, lidhur me nacionalizmin, etnicitetin, de-etnicitetin e sferës e publike, migrimin, integrimin. Diskutimet shkencore do të zhvillohet nëpërmjet debateve, ligjëratave dhe punëtorive. Krijimi i një platforme alternative të të mësuarit për studime të avancuara, për studentët master, studentët doktoraturë, hulumtues të rinj, zyrtarë të rinj publik – është edhe qëllimi kryesor i kësaj shkolle verore.

Kjo shkollë verore do të realizohet nga data 19 Korrik - 01 Gusht 2010, në qytetin Komárno - Republika e Sllovakisë. Gjuha e punimeve: Gjuha angleze.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- o aplikacionin (e gjeni në zyrat te QeSHK ose http://www.cvek.sk/uploaded/files/Application_form.doc)
- o letër motivimi
- o autobiografi e shkurtër (CV)
- o një letër rekomandimi (nga profesorë relevantë ose punëdhënës)

Dokumentet e kompletuara, duhet të dërgohet me postë në adresën:

CVEK – Center for the Research of Ethnicity and Culture
Klariská 14
811 03 Bratislava
Slovak Republic

Po ashtu, dokumentet e lartpërmendura duhet të dërgohet edhe në formë elektronike në adresën: novakova@cvek.sk

Aplikimet apo kandidatët e pranuar, publikisht do të informohen më datë 30 Maj 2010, nëpërmjet ueb-portalit: www.cvek.sk

AFATI I FUNDIT PËR DËRGIMIN E APLIKIMEVE ËSHTË DATA: 24 MAJ 2010.

Shpenzimet: Regjistrimi për kandidatët e pranuar kushton 50 euro. Shpenzimet për programin veror, materialet studimore, transportin përgjatë shkollës verore, si dhe akomodimi dhe ushqimi janë të mbuluara nga organizatorët. Pjesëmarrësit janë obliguar t'i mbulojnë shpenzimet e udhëtimit dhe sigurimin shëndetësor.

Për informacione më të detajuara vizitoni Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë - QeSHK.